



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA E OFRIMIT TË  
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË  
INTEGRUARA (ADISA)**

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE  
EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
PRONËSISË INDUSTRIALE**

Nr. 1002 prot.  
Tiranë, më 21.12.2020

Nr. 870 prot.  
Tiranë, më 21.12.2020

## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

### **NDËRMJET**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE  
(DPPI)**

***DHE***

**AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË  
INTEGRUARA (ADISA)**

Me dëshirën për të mbështetur, zhvilluar dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve tona, me fokus në promovimin e fushës së pronës industriale, në Republikën e Shqipërisë, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi këtë fushë, palët bien dakord të lidhet një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet:

**Drejtoria e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI)**, me seli në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, i cili është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim- Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Ledina Beqiraj (Agalliu), këtu e në vijim “*DPPI*”,

*DHE*

**Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)**, me seli në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, i cili është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Lorin Ymeri, këtu e në vijim “*ADISA*”,

Palët, bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “**Memorandumi**”), si më poshtë vijon:

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi ndërmjet palëve me qëllim promovimin e shërbimeve të ofruara në fushën e pronësisë industriale dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi këtë fushë nëpërmjet koordinimit të institucioneve të specializuara, Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Drejtoria e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).

### **Neni 2 Objekti**

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përmirësimin e shërbimeve të ofruara në fushën e pronësisë industriale, nëpërmjet trajnimit të stafit që ofron shërbime publike si dhe informimit në lidhje me objektet e pronësisë industriale për të gjithë të interesuarit që marrin shërbimin në sportelet e ADISA.

### **Neni 3** **Përgjegjësitë e palëve**

Bashkëpunimi sipas këtij memorandum realizohet si vijon:

**1. Palët nëpërmjet strukturave të përcaktuara për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Memorandumi, marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:**

- Të përcaktojnë projekte bashkëpunuese me interes për të dyja Palët;
- Të lehtësojnë aktivitetet e dakordësuara në mënyrë reciproke, në përputhje me politikat dhe procedurat e secilës Palë;
- Të mbajnë komunikim efektiv ndërmjet tyre, për të realizuar projekte, apo trajnime me interes për të dyja Palët;
- Të ndajnë njohuritë dhe të dhënat që avancojnë interesin reciprok të Palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e secilës Palë;
- Të publikojnë dhe të shpërndajnë rezultatet e bashkëpunimit, në përputhje me politikat e secilës palë;
- Palët do të veprojnë në besueshmëri të plotë, për të siguruar arritjen e të gjithë objektivave të marrëveshjes.

**2. Drejtoria e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), do të realizojë:**

- Trajnimin e punonjësve të ADISA-s, të cilët ofrojnë shërbime publike pranë Zyrave Rajonale/Vendore, në lidhje me rëndësinë që ka regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale;
- Hartimin e një kalendari paraprak në fillim të vitit, lidhur me zhvillimin e trajnimeve, dhe shpenzimet për personelit e DPPI do të mbulohen nga buxheti i DPPI-së;
- Vendosjen në dispozicion të sporteleve të ADISA-s materiale informuese në lidhje me objektet e pronësisë industriale për të gjithë të interesuarit që marrin shërbimin në sportelet e ADISA.

**3. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) do të realizojë:**

- Ofrimin/asistimin e qytetarëve pranë Zyrave Rajonale/Vendore të saj, lidhur me shërbimet publike të ofruara nga DPPI;
- Vendosjen në dispozicion të DPPI, të punonjësve të Zyrave Rajonale/Vendore, me qëllim zhvillimin e trajnimit të tyre, lidhur me regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale;

- Vendosjen e materiale informuese, të përcjella nga DPPI, lidhur me objektet e pronësisë industriale për të gjithë të interesuarit që marrin shërbimin në sportelet e Zyrave Rajonale/ Vendore të ADISA-s.

#### **Neni 4**

##### **Komunikimi ndërmjet palëve**

Për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm me qëllim zbatimin e pikave të këtij Memorandumi, palët caktojnë personat dhe pikat e kontaktit përkatëse, si më poshtë:

##### **Për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA):**

Znj. Deborah Hatellari

Pozicioni: Përgjegjës, Sektori i Planifikimit dhe Menaxhimit të Projekteve.

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, "ish Hoteli i Oficerave", Tiranë

E-mail: [deborah.hatellari@adisa.gov.al](mailto:deborah.hatellari@adisa.gov.al)

##### **Për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI):**

Znj. Sonila Meka

Pozicioni: Përgjegjës Sektori i Koordinimit, Analizës dhe Raportimeve

Adresa: Blv. "Zhan D'Ark" prona nr. 33, Tiranë

E-mail: [Sonila.meka@dppi.gov.al](mailto:Sonila.meka@dppi.gov.al)

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja e Memorandumit**

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet për një afat kohor prej 1 (një) viti.

Memorandumi rinovohet automatikisht për një periudhë kohe të pacaktuar, nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palën tjetër për përfundimin e saj, para përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni.

#### **Neni 6**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga interpretimet eventuale të ndryshme gjatë zbatimit të këtij memorandumi do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.

**Neni 7**  
**Zgjidhja e Memorandumit**

Palët mund të zgjedhin të largohen nga ky memorandum duke e njoftuar njëra-tjetrën me një shkresë zyrtare, 15 ditë përpara largimit.

Nëse secila nga Palët zgjedh të largohet nga ky Memorandum, në përputhje me parashikimet e këtij Neni, është i detyruar të përfundojë projektet për të cilat palët janë përfshirë bashkërisht.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

**Neni 9**  
**Dispozita të fundit**

Ky memorandum bashkëpunimi, në rast nevoje, mund të ndryshohen apo shtohet, duke dakordësuar paraprakisht me shkrim ndërmjet Palëve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u hartua në 2 (dy) kopje, nga 1 (një) kopje për secilën palë, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe.


**PALËT**

**PËR**

**AGJENCINË E OFRIMIT TË  
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË  
INTEGRUARA (ADISA)**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Lorin Ymeri**



**PËR**

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË  
PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ledina Beqiraj (Agalliu)**

